



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.504/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malësore Gashi Bajraktari-anëtare, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 504/2026 të datës 06.05.2026, të parashtruar nga ankuesi V.S, kundër organit të punësimit/Komuna e Graçanicës, në çështjen juridike “Pezullim i Marrëdhënies së Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shpallet jo kompetent për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën A.nr. 04/2026, e datës 06.05.2026, e parashtruar nga ankuesi V.S.

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje Komisionit për Ankesa, në Komunën e Graçanicës.

A r s y e t i m

Ankuesi, V.S (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 06.05.2026 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar nën shenjën A.nr.504/2026, lidhur me Aktvendimin me numër protokolli 4198/2025, të datës 03.10.2025, të nxjerr nga Drejtoresha e Arsimit në Komunën e Garancisë, lidhur me pezullimin e marrëdhënies së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.05.2026 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Graçanicës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 19.05.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa me numër protokoli 2182/2026 e datës 06.05.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimi për pezullimin e marrëdhënies së punës me numër protokoli 4198/2025, e datës 03.10.2025; Kontrata e Punës me numër protokoli 5177/2021, e datës 29.10.2021, për ankuesin V.S; Marrëveshja për punësim të Përkohshëm me numër protokoli 5791/2021, e datës 02.12.2021, i nxjerr nga Drejtori i Administratës ; Aktvendimi me numër protokoli 5792/2021, i datës 02.12.2021, , i nxjerr nga Drejtori i Administratës; Kontrata e Punës me numër protokoli 2087/2021, e datës 29.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.05.2026, dërguar nga S.A, për S.S,S; Përgjigje në ankesë me numër protokoli A. nr.507/2026, e datës 19.05.2026.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.504/2026, e datës 06.05.2026, të parashtruar nga ankuesi, V.S sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi V.S. sipas kontratës së punës me numër protokoli 2087/2021, të datës 29.04.2022, mbanë pozitën e punës “Profesor i së Drejtës Kushtetuese”, në Shkollën e Ekonomisë dhe Tregtisë në Llapnasellë, në Komunën e Graçanicës

Tutje Drejtoresha e Arsimit në Komunën e Graçanicës, përmes Aktvendimit me numër protokoli 4198/2025 të datës 03.10.2025, ankuesin e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës në kohë të pacaktuar në vendin e punës, Profesor në Departamentin e Arsimit, përkohësisht i sistemuar në Departamentin e Kadastrit, në Komunën e Graçanicës (sistemi i përkohshëm në Drejtorin e Kadastrit ka qenë i kundërligjshëm sepse është bërë pa asnjë procedurë për pranim në shërbimin civil të Kosovës), me arsyetimin suspendohet sipas detyrës Zyrtare bazuar në procedurën e iniciuar penale.

Ankuesi, V.S, me datë 06.05.2026, ka parashtruar ankesë, me numër protokoli 2182/2026, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimor lidhur me anulimin e suspendimit dhe kthimin në vendin e punës.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranueshmeris së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 5 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës,* dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi për shkak të pozicionit të punës që mbanë aktualisht si Profesor i së Drejtës Kushtetuese”, në Shkollën e Ekonomisë dhe Tregtisë në Llapnasellë, në Komunën e Graçanicës, sipas kontratës së punës me numër protokoli 2087/2021, të datës 29.04.2022, ofron shërbime në fushën e arsimit për çka edhe nuk e ka statusin e Nëpunësit të Shërbimit Civil, por i njëjti e gëzon statusin e Nëpunësit të Shërbimit Publikë, sikurse përcaktohet me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Pas konstatimit si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.395/2026 të datës 02.04.2026 dhe meqenëse nga shkresat e lëndës nuk vërehet se pala ankuese nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 15, të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publik, si dhe nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 504/2026 të datës 06.05.2026 dhe të bartë lëndën të organi kompetent, në këtë rast Komisioni i Ankesave në Komunën e Graçanicës.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA : A.nr.504/2026

Rushit Kajtazi

Eshref Shabani

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, V.S
- Komisionit për Ankesa në Komunën e Graçanicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Graçanicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;